




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 20/DPK	Nr Prot. Br Prot. 01-559/16
Nr. i faq. Broj stranica 02	Data Datum 10.02.2016
PRISTINE	



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	10/02/2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Driton FETAJ Udhëheqëse e Departamentit të Prokurimit në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka"
CC:	z. Adnan LATAJ Ud. Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka"
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Furnizim me paisje të IT-së për projektin TEMPUS Consus"



I nderuari z. Fetaj,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin lidhur me Tenderin "**Furnizim me paisje të IT-së për projektin TEMPUS Consus**" me numër prokurimi: 208 16 001 121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "**Furnizim me paisje të IT-së për projektin TEMPUS Consus**" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Univerversiteti i Pejës, si Autoritet Kontraktues ka përgatit Njoftimin për Kontratë me titull: **“Furnizim me pajisjet të IT-së për projektin TEMPUS Consus”** me numër të prokurimit: 208 16 001 121. Ky aktivitet i prokurimit më datë 26/01/2016 është publikuar në web faqen e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik. Agjencia kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet Prokurimi si rast për trajtim dhe gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit nga Dosja Tenderit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me Procedurat e Prokurimit në Kosovë.

Në Seksionin II.Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), pika 9.1, Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale kërkohet: Pajisjet dueht të jenë prodhim me origjinë BE. Po ashtu tek Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme për LOT 1 është cekur, Vërejtje: Pasi që Mjetet janë donacion nga projekti Cnsus Operatorët Ekonomik dueht të plotësojnë kushtet e kërkuara nga donatori.

Qertifikata e prodhuesit për pajisje nga ndonjeri vend me origjinë të Bashkimit Evropian + Shtett Norvegjia, Lithenshtajni dhe Islanda (Pajisjet duhet të jenë nga vendet e lartëcekura).

Autoriteti Kontraktues ka paracaktuar dhe kufizuar origjinën e produktit, me paracaktimin e vendit të origjinës për produktet furnizuese, Autoriteti Kontraktues favorizon Operator të caktuar Ekonomik dhe në të njëjtën kohjë diskriminon të tjerë. Autoriteti kontraktues mund ti referohet një standardi vendor ose ndërkombëtar për furnizim me produkte, por asesi të kufizohet nga vende të caktuara. Bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurim publik, një gjë e tillë nuk është e lejuar dhe nuk i jep hapësirë konkurrencës së lirë legale.

Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga Autoriteti Kontraktues, Agjencia kundër Korrupsionit ka analizuar me kujdes Çertifikatën e Autorizimit të cilën e ka lëshuar Universiteti i Grazit për këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo nuk ka gjetur të dhëna të cilat e detyrojnë Autoritetin Kontraktues që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit për këtë aktivitet duhet ti hartojnë kërkesat e cekura si më lartë. Por në këtë Autorizim në mënyrë decitive është e cekur këto pajisje do të blihen në bazë të **ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës me NR.04/L-042** .

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!



